

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6743
E premte, 28 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Berisha dhe Meta
shkojnë bashkë në
zgjedhjet lokale | FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA E KOMISIONIT EVROPIAN, URSULA VON DER LEYEN,
KA VIZITUAR TË ENJTEN KOSOVËN | FAQE 4-5

VON DER LEYEN: KOSOVA E MERITON LIBERALIZIMIN E VIZAVE, I KA PËRMBUSHUR TË GJITHA KRITERET



Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, ka thënë se Kosova meriton liberalizimin e vizave pasi ka përbushur të gjitha kriteret. "Ju dëgjoj qartë në çështjen e liberalizimit të vizave. E dini se keni një aleat dhe mua personalisht. Kosova e meriton

liberalizimin e vizave. I keni përbushur të gjitha kushtet", ka thënë Von der Leyen të enjten në Prishtinë. Ajo ka konfirmuar se Bashkimi Evropian pritet të ndajë 75 milionë euro si ndihmë të menjëhershme për Kosovën në përballimin e krizës energjetike

OPINION

MODELI I DY GJERMANIVE,
SIKUR MODELI I DY SERBIVE!

F. 6

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



BISLIMIT I NDALOHET VIZITA NË
BEOGRAD "PËR SHKAQE SIGURIE" F. 5

MBP-ja PRANON 80 KOMENTE PËR
PROJEKTLIGJIN PËR PAGAT F. 7

EKONOMI



KUVENDI MIRATON PROJEKTLIGJIN
QË PËRCAKTON ÇMIMIN TAVAN PËR
PRODUKTET BAZË F. 8

MBAHET FORUMI I BIZNESIT
GREQI - KOSOVË F. 8

SPORT



FBK-JA NDALON UDHËTIMIN E
TIFOZËVE MYSAFIRË F. 10



RAKIQI
PARALAJMËRON
BLLOKIM TË
RRUGËVE NË VERI
NË RAST TË
KONFISKIMIT TË
MAKINAVE ME
TARGA SERBE | FAQE 7



DEPUTETI UKRAINAS NË KUVENDIN E
KOSOVËS: UKRAINA DUHET TA NJOHË
SHTETIN TUAJ TË PAVARUR | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Lufta në Ukrainë, BE-ja forcon ligjet për tregtinë e armëve

BRUKSEL, 27 TETOR - Bashkimi Evropian ka vendosur që t'i forcojë ligjet që rregullojnë tregtinë dhe transportin e armëve si një përpjekje për ta parandaluar rënien e armëve në duart e bandave kriminale mes shqetësimeve se lufta në Ukrainë mund ta rrisë përhapjen e armëve të paligjshme.

Komisioni Evropian vlerëson se rreth 35 milionë armë të paligjshme janë në duart e civilëve në të gjithë bllokun. Rreth 630 000 armë zjarri janë të listuara si të vjedhura në bazën e të dhënave të sigurisë dhe kufirit të BE-së.

Ky vendim i Komisionit Evropian përfshin procedura më të qarta dhe të përbashkëta për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit dhe municioneve. Një sistem elektronik licencimi do të vihet në funksion për aplikimet e importit dhe eksportit për t'i zëvendësuar sistemet më të ngadalta të bazuara në letër që kanë shumica e vendeve.

Standarde më të rrepta do të vendosen për prodhimin e armëve alarmuese dhe

sinjalizuese. Armët e tilla u konvertuan nga ekstremistët dhe u përdorën në sulmet e përgjakshme të Parisit në vitin 2015 dhe në vrasjen e stafit të revistës satirike franceze "Charlie Hebdo".

Certifikatat e përdoruesit përfundimtarë do të kërkohen për lloje të caktuara të armëve të zjarrit për të siguruar që marrësi nuk planifikon t'i transferojë ato te dikush tjetër, duke ndihmuar në uljen e rrezikut që armët mund të shfaqen në tregun e zi.

Komisioni këmbëngul se masat nuk do ta kufizojnë zotërimin e armëve dhe, në fakt, do t'i thjeshtojnë procedurat për gjuetarët dhe garuesit.

Komisionarja e Punëve të Brendshme, Ylva Johansson, u kërkoi vendeve anëtare të BE-së dhe Parlamentit Evropian që t'i miratojnë ato me shpejtësi.

Johansson tha se një raport i agjencisë policore evropiane tregon se "grupet e organizuara kriminale po bëhen gjithnjë e më të dhunshme dhe se dhuna po bëhet gjithnjë e më vdekjeprurëse. Ky është një kërcënim për sigurinë tonë", ka



deklaruar ajo.

Propozimet e komisionit u hartuan shumë përpara se Rusia ta pushtonte Ukrainën në muajin shkurt të këtij viti, por Johanssoni tha se konflikti ka ngritur shqetësime pasi armët

që u përdorën në luftërat që copëtuan ish-Jugosllavinë në vitet 1990 janë duke hyrë ende në Evropë. "Sigurisht që unë i besoj ushtrisë ukrainase - ata me të vërtetë po i përdorin armët në mënyrën e duhur -

por ne, gjithashtu, e dimë se lufta është një fatkeqësi për njerëzit, por është një mundësi për kriminelët, dhe ne duhet të jemi të përgatitur për këtë", u tha Johansson gazetarëve në Bruksel.

Zelensky: Taktikat ruse janë "të çmendura"



KIEV, 27 TETOR - Forcat ruse kanë nisur sulme të reja në Kiev dhe në Zaporizhja, thanë zyrtarët dhe ushtria më 27 tetor, teksa forcat ukrainase kanë zbrapsur sulmet në dy qytete në rajonin lindor të Donbasit. Guvernatori rajonal i Kievit, Oleksiy Kuleba, shkroi në "Telegram" se ekipet e

shpëtimit janë në vendin ku ndodhi sulmi ajror në kryeqytet, por nuk tregoi lokacionin. "Gjatë natës rusët terrorizuan rajonin e Kievit. Kemi pasur sulme në një prej komuniteteve të rajonit. Ekipet e shpëtimit dhe të gjitha shërbimet e emergjencës janë në vendin e ngjarjes. Përpjekjet

për shuarjen e zjarrit dhe pasojat e sulmit ende po vazhdojnë", tha Kuleba.

Në Zaporizhja rusët kanë përdorur raketa të llojit Smerch për ta shënjestruar qytetin gjatë natës, tha kreu i administratës ushtarake rajonale, Oleksandr Starukh. "Natën armiku ka sulmuar në periferi të rajonit.

Sipas informacioneve preliminare, ato ishin tri predha të sistemit raketahedhës Smerch. Nuk ka viktima", shkroi ai në "Telegram".

Starukh tha se është shkatërruar infrastruktura dhe për shkak të sulmeve ka shpërthyer zjarr.

Pjesë të rajonit të Zaporizhjes, që gjendet në juglindje të Ukrainës, janë nën pushtimin rus, por kryeqyteti rajonal është ende nën kontrollin ukrainas.

Zaporizhja është një prej katër rajoneve pjesërisht të pushtuara nga Rusia që Moska pretendon se i ka aneksuar pas mbajtjes së referendumeve të rreme, që janë dënuar nga Ukraina dhe aleatët perëndimorë.

Ndërkaq, në rajonin lindor të Donbasit forcat ukrainase po zbrapsin sulmet ruse në afërsi të qyteteve Avdiyavka dhe Bahmut ku po zhvillohen luftime të ashpra, tha më 26 tetor presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. Ai i akuzoi komandantët rusë për "çmenduri" në përpjekjet e tyre për ta marrë kontrollin e qyteteve. "Çmenduria e komandantëve rusë është më e dukshme këtu. Ditë pas dite, për muaj të tërë, ata kanë shtyrë njerëzit drejt vdekjes,

duke përqendruar sulmet e artilerisë", tha ai.

Forcat ruse po vazhdojnë përpjekjet për ta marrë Bahmutin, që gjendet në rrugën kryesore që çon drejt Sllovjanskut dhe Kramatorskut. Inteligjenca britanike tha se Moska po tenton ta marrë Bahmutin pasi e sheh si parakusht për avancimin drejt këtyre dy qyteteve - që janë qytetet kryesore që Ukraina kontrollon në rajonin lindor të Donjeckut.

Autoritetet ukrainase, përfshirë Zelensky, nuk kanë dhënë informacione të reja lidhur me situatën në rajonin jugor të Hersonit, që ka qenë skenë luftimesh kohën e fundit. "Në përgjithësi ne po forcojmë pozicionet tona në të gjitha frontet, duke ulur aftësitë e pushtuesve, duke dëmtuar logjistikën e tyre dhe duke u bërë gati për lajme të mira për Ukrainën", tha ai.

Rusia, që ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, së fundmi ka pretenduar se Kiev po përgatitet të kryejë sulm me "bomba ndotëse". Këto akuza janë hedhur poshtë nga Ukraina dhe aleatët e saj. "Bombat ndotëse" janë bomba konvencionale të mbushura me materiale radioaktive, biologjike dhe kimike.

Deputeti ukrainas në Kuvendin e Kosovës: Ukraina duhet ta njohë shtetin tuaj të pavarur

“Epoka e re”

Prishtinë, 27 tetor - Deputeti ukrainas Oleksiy Goncharenko nga Kuvendi i Kosovës ka bërë thirrje që Ukraina ta njohë shtetin e Kosovës. Ai ka thënë se do të punojë në këtë drejtim, derisa ka theksuar se më 5 gusht i ka thënë parlamentit ukrainas që ta njohë pavarësinë e Kosovës si shtet i pavarur. “Unë mendoj se kjo duhet të bëhet sa më parë, sepse ju keni luftuar për lirinë e juaj, ju jeni një shtet i pavarur. Unë do të bëj çfarëdo që është në fuqinë time që t’ju ndihmoj për këtë. Në parlamentin ukrainas kemi organizuar një kauzë për miqtë e Kosovës dhe unë kam nderin që të jem kryetar i kësaj kauze. Dhe mund të llogaritni në ne në çdo moment. Do të bëjmë çfarëdo që është e mundur që t’ju ndihmojmë të ecim kësaj rruge së bashku me ju”, ka thënë Goncharenko para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Goncharenko, gjithashtu, ka premtuar mbështetje të pazërvë që Kosova të bëhet anëtare me të drejta të plota në Këshillin e Evropës, aty ku ka aplikuar këtë vit. “Edhe si anëtar

i Parlamentit të Këshillit të Evropës, si zëvendës-president i Komisionit për Refugjatët dhe Migrim në Këshillin e Evropës, dua t’ju siguroj se unë aty do të bëj çfarëdo që është e mundur që ta mbështes Kosovën që të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës me të drejta të plota sa më parë që është e mundur. Kosova është Evropa. Unë besoj në këtë”, ka thënë deputeti ukrainas Goncharenko.

Para deputetëve të Kosovës ai ka shtuar se ushtria ruse nuk mund të bëjë asgjë në Ukrainë, vetëm se po hakmerret ndaj civilëve dhe njerëzve të pafajshëm. Ai ka kërkuar edhe nga Kuvendi i Kosovës që ta cilësojë si regjim terrorist luftën që po bën Rusia kundër Ukrainës. “Unë erdha nga Brukseli dje dhe dua t’ju them se në fund të nëntorit Parlamenti Evropian do të votojë për ta cilësuar si regjim terrorist regjimin rus. Këshilli i Evropës e ka bërë këtë në tetor. Dje është bërë nga senati në Poloni dhe kërkoj edhe nga ju ta bëni një gjë të tillë. Që ta cilësoni këtë regjim rus si një regjim terrorist, i cili është duke bërë një gjenocid kundër ukrainasve. Ky është fakt”, ka thënë deputeti ukrainas Oleksiy Goncharenko.



Berisha e Meta shkojnë bashkë në zgjedhjet lokale

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha dhe ai i Partisë së Lirisë, Ilir Meta, kanë firmosur marrëveshje për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 14 maj të 2023-s. Sipas marrëveshjes, Berisha - Meta do të dalin me një kandidat të përbashkët për kryetarë bashkishë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

TIRANË, 27 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Sali Berisha dhe kryetari i Partisë së Lirisë, Ilir Meta, kanë arritur të enjten marrëveshje bashkëpunimi për zgjedhjet lokale të cilat do të mbahen më 14 maj 2023. Para se të hidhnin nënshkrimet në marrëveshje, dy aleatët opozitarë, Berisha dhe Meta, zhvilluan një takim, më pas zyrtarizuan marrëveshjen e tyre. Në marrëveshjen me 6 pika, dy aleatët tashmë në opozitë pajtohen që t’i ofrojnë Shqipërisë një alternativë fituese në zgjedhjet lokale, që përfaqëson, sipas tyre, vetëm interesat e qytetarëve dhe interesin më të lartë publik.

Në marrëveshjen e firmosur palët pajtohen që konkurrimi për kryetarët e Bashkive do të bëhet me kandidatë të përbashkët, të cilët vendosen nga rezultati i konkurrimit në primare, ndërsa Këshillat Bashkiake, si institucionet më të rëndësishme të

përfaqësimit të qytetarëve, do të drejtohen nga përfaqësues të propozuar nga Partia e Lirisë, në rastet kur këshilltarët e kësaj të fundit rezultojnë përcaktues në sigurimin e shumicës në këta këshilla.

Berisha e ka quajtur marrëveshje historike paktin e nënshkruar me kreun e Partisë së Lirisë, Ilir Meta, që dy liderët t’i bashkojnë forcat për zgjedhjet e 14 majit.

“Moment historik në zhvillimin politik të Shqipërisë. Ky moment shënon marrëveshjen për betejën dhe fitoren e sigurt të opozitës në Tiranë dhe në Shqipëri, qytetarin e parë që ata meritojnë, që pasqyrojnë vlerat dhe virtytet e tyre dhe, po ashtu, të gjithë Shqipërisë. Për t’i dhënë vendit përfaqësuesit dinjitozë, për t’i dhënë Tiranës një parlament të fuqishëm të kryesuar nga qytetarë dhe politikanë të sprovuar”, ka thënë Berisha.

Ndërkaq kreu i Partisë së Lirisë, Ilir Meta, marrëveshjen e arritur me Berishën e ka cilësuar garanci për rezultate pozitive të opozitës në zgjedhjet lokale të 14 majit.



“Është marrëveshja më parimore që i shërben demokracisë. Referendumet, primaret, transparenca, llogaridhënia do të bëjnë të mundur të kemi një

sovrani që i ka të gjitha mjetet për të mbajtur në kontroll të gjithë ata që i delegon pushtetin. Shpreh kënaqësi që angazhimi madhor që unë dhe Partia e Lirisë ka

marrë mbrëmjen e 25 korrikut sot merr mbështetje të madhe nga PD-ja, si forca më e madhe opozitare për referendimet”, ka deklaruar Meta.



PRESIDENTJA E KOMISIONIT EVROPIAN, URSULA VON DER LEYEN, KA VIZITUAR TË ENJTEN KOSOVËN

Von der Leyen: Kosova e meriton liberalizimin e vizave, i ka përmbushur të gjitha kriteret

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, ka thënë se Kosova meriton liberalizimin e vizave pasi ka përmbushur të gjitha kriteret. “Ju dëgjoj qartë në çështjen e liberalizimit të vizave. E dini se keni një aleat dhe mua personalisht. Kosova e meriton liberalizimin e vizave. I keni përmbushur të gjitha kushtet”, ka thënë Von der Leyen të enjten në Prishtinë. Ajo ka konfirmuar se Bashkimi Evropian pritet të ndajë 75 milionë euro si ndihmë të menjëhershme për Kosovën në përballimin e krizës energjetike

**EPOKA
ERE** Mal QORRAJ

Prishtinë, 27 tetor - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, ka thënë se Kosova meriton liberalizimin e vizave. Në një konferencë për medie pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, ajo ka thënë se Kosova ka përmbushur kriteret për këtë proces. “Ju dëgjoj qartë në çështjen e liberalizimit të vizave. E dini se keni një aleat dhe mua personalisht. Kosova e meriton liberalizimin e vizave. I keni përmbushur të gjitha kushtet”, ka thënë Von der Leyen. Ajo ka thënë se tani është koha të

bindet Këshilli Evropian për liberalizimin e vizave. “Detyra tani është që ta bindim tërë Këshillin Evropian. Shumica prej tyre janë në anën tuaj. Mund të llogarisni tek unë personalisht, sepse do të bëjmë gjithçka për t’ju ndihmuar që të arrini këtë”, ka thënë Von der Leyen.

Ajo ka shtuar se Kosova ka bërë një punë të mrekullueshme në sundimin e ligjit, luftimin e korrupsionit dhe krijimin e një ekonomie të lirë të tregut. “E di që vendi juaj vazhdon të demonstrojë përkushtim shumë të madh në rrugëtimin evropian. Keni treguar vlerat tuaja drejt integritetit evropian. Dhe u jeni bashkuar

sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë. Jeni duke marrë reforma ambicioze, ju uroj për këtë. Kjo punë e zellshme që ka bërë Kosova është reflektuar edhe në raportin e fundit për zgjerim që është pozitiv për Kosovën. Keni bërë përparim

dhe përpjekjeje për ta luftuar korrupsionin dhe kjo është e mirë. Jeni duke e ndërtuar hap pas hapi jo vetëm gjyqësorin, por edhe një ekonomi të lirë të tregut”, ka thënë ajo.

Presidentja e Komisionit Evropian,

Ursula Von der Leyen, ka bërë me dije se Bashkimi Evropian pritet të ndajë 75 milionë euro si ndihmë të menjëhershme për Kosovën për përballimin e krizës energjetike. “Ne do t’i finalizojmë të gjitha procedurat e nevojshme deri në



Foto: Zyra e Kryeministrit të Kosovës

Bislimit i ndalohet vizita në Beograd “për shkaqe sigurie”

PRISHTINË, 27 TETOR - Zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi, i është ndaluar vizita dyditore në Serbi nga policia e këtij shteti “për shkaqe sigurie” pak para se të arrinte në Beograd.

Këtë e konfirmoi për “Radion Evropa e Lirë” zëdhënësi i Bislimit, Klisman Kadiu. Pas kësaj, ai është kthyer drejt Kosovës.

Bislimi ishte nisur drejt Beogradit më 27 tetor për të marrë pjesë në dy tryeza diskutimi për çështjet e dialogut Kosovë - Serbi.

Bislimi që, njëherësh, është udhëheqës i bisedimeve me Serbinë në nivel të kryenegociatorëve, ishte paraparë të merrte pjesë në diskutimet me temën “Kosova dhe perspektiva evropiane e rajonit”, në kuadër të Forumit për Marrëdhënie Etnike që mbahet më 27 shtator.

Ai, po ashtu, pritej që të premtën

të merrte pjesë në Konferencën e Sigurisë së Beogradit dhe do të jetë pjesë e panelit me temën “Kosova dhe Serbia - shmangia e rrugës pa dalje”.

Edhe më herët Bislimi kishte vizituar Serbinë. Në shtator, së bashku me ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci, kishin vizituar komunat në jug të Serbisë, të banuara me shumicë shqiptare. Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog për normalizimin e raporteve me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian që nga viti 2011. Faktori ndërkombëtar po bën përpjekje që t'i inkurajojë palët që ta përmbyllin këtë proces. Por, dy shtetet kanë qëndrime të ndryshme sa i përket fundit të procesit. Kosova kërkon që në një marrëveshje përfundimtare të përfshihet edhe njohja reciproke, ndërkaq Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.



Kryeauditorja përmend në Kuvend pagesat për serbët pa shkuar në punë

PRISHTINË, 27 TETOR - Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit, Vlora Spanca, ka përmendur të enjten para deputetëve pagesat për serbët, pa shkuar fare në punë. Spanca në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, derisa ka paraqitur konkluzionet e raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021, ka bërë me dije se janë kryer pagesa mbi 900 mijë euro për punonjësit e komunitetit serb. “Kryerja e pagesave në vlerë prej mbi 900 mijë eurosh për 199 punonjës të komunitetit serb të angazhuar në bazë të marrëveshjes së Brukselit, pa u evidentuar vijueshmëria e tyre në punë. Në këtë raport për vitin 2021, po ashtu kemi dhënë konkluzione të pajtueshmërisë të përmbledhur nga auditimi i 90 organizatave buxhetore”, ka theksuar Spanca. Para deputetëve ajo ka thënë se



konkluzionet janë se organizatat buxhetore në fushën e raportimit financiar vazhdojnë të kenë

mangësi të theksuara në prezantimin e informatave financiare. “Për raportin

financiar të qeverisë për buxhetin e republikës kemi dhënë opinion të modifikuar,

përkatësisht opinion të klasifikuar. Shpenzimet prej 13 milionë eurosh janë klasifikuar në kategorinë joadekuate, prej të cilave janë keqklasifikuar 9.3 milionë euro, pastaj për shkak të vendimeve gjyqësore janë afër 2 milionë euro, ndërsa si të ndikuara nga vetë organizatat buxhetore vlera e keqklasifikimeve ishte rreth 2 milionë euro”, ka theksuar ajo.

Spanca ka shtuar se janë nxjerrë 132 raporte individuale të organizatave buxhetore, ndërmarrjeve publike, projekteve dhe atyre të performancës.

Me 66 vota për janë miratuar rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e Auditimit të Përgjithshëm për Raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021.

fund të vitit që ju të mund ta merrni fondin që në janar”, ka thënë ajo në një konferencë të përbashkët pas takimit me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani.

Përveç mbështetjes së menjëhershme për krizën aktuale, Von der Leyen tha se pritet të ketë një investim tjetër prej 500 milionë eurosh për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Duam t’ju ndihmojmë në pavarësinë tuaj energjetike. Qasja jonë është se do të ofrojmë mbështetje të fortë për të ndërtuar kapacitete të reja, për ta zëvendësuar qymyrin me energji të ripërtërishme”, ka deklaruar Von der Leyen.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duke falënderuar BE-në për mbështetjen për përbashkëtimin e krizës energjetike, ka pohuar se është vendimtare që BE-ja të “na qëndrojë pranë dhe të na mbështesë me përbashkëtimin me krizat, si ajo energjetike”. “Falënderim i përzemërt për presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, për këto mesazhe inkurajuese e mbështetëse për Republikën e Kosovës. Llogarisim në leadershipin tuaj përderisa ndërmarrim hapa të guximshëm drejt sundimit të plotë të ligjit dhe mbrojtjes së vlerave evropiane”, ka thënë Osmani.

Presidentja e Komisionit Evropian,

Ursula Von der Leyen, është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti. Në këtë takim, kryeministri Kurti e njoftoi Von der Leyen për avancimin e vazhdueshëm që Kosova po shënon në indikatorët ekonomikë dhe demokratikë dhe për punën e qeverisë në reformën në drejtësi, përmbylljen e agjendës evropiane dhe për luftimin e krimit dhe korrupsionit. Kurti veçoi të gjeturat e raportet ndërkombëtare që dëshmojnë për përparimin gradual, por të vazhdueshëm të Republikës së Kosovës në shumë fusha.

Sa i përket rrugës së Republikës së Kosovës drejt Bashkimit Evropian, kryeministri Kurti tha se Kosova do

të aplikojë për anëtarësim në Bashkimin Evropian para përfundimit të këtij viti. Ai ka thënë se ky vendim vjen si rezultat i orientimit politik dhe vleror sa i qeverisë ashtu edhe i qytetarëve të Republikës të cilët mbështesin masivisht dhe plotësisht integrimin në BE. Ndërkaq sa i përket liberalizimit të vizave, kryeministri Kurti u shpreh se Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret dhe se liberalizimi tashmë është më se meritore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në këtë takim u diskutua edhe për krizën energjetike me të cilën po përballet i gjithë kontinenti evropian.

Kryeministri Kurti shprehu falënderimin e tij për këtë mbështetje e cila do të ndihmojë drejtpërdrejt në minimizimin e efekteve të krizës energjetike te qytetarët tanë.

Pas takimit, kryeministri Kurti dhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, vizituan së bashku objektin e Fakultetit të Arkitekturës. Falë financimit të Bashkimit Evropian, objekti tani ka një sistem të ri të ngrohjes qendrore, ndërkaq Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet bashkëpunimit me Bankën Botërore ka investuar në eficientësinë e energjisë së këtij objekti.

MODELI I DY GJERMANIVE, SIKUR MODELI I DY SERBIVE!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Marrëveshja përfundimtare, me e pranuar, pa e lexuar. Në opinion doli një konceptletër se si dukej në vija të trasha marrëveshja përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë e që për bazë e kishte modelin e dy gjermanive. Ky propozim u publikua me një paralajmërim nga "Albanian Post", pas së cilës filloi një fushatë linçuese kundër Baton Haxhiut, ndonëse nuk kishte asnjë përgjegjësi për këtë propozim. Ky model u emërtua si propozim franko-gjerman duke e konsideruar si një mundësi të artë për Kosovën ani pse zgjidhjen përfundimtare e zhvendos në një të ardhme, fillimisht duke paraparë hipotetikisht se njohja nga Serbia mund të ndodhë pas 10 vjetëve nëse në ndërkohë nuk ndryshon situata.

Në këtë propozim asgjë dhe asnjë çështje nuk zgjidhet në formë të prerë, por lëndëzohet (sipas kryeministrit), i cili fillimisht e mohoi se ka një propozim të tillë sikur edhe presidentja e kryeministrit Kurti, Vojsa Osmani e cila pas një kohe e pranoi se qenka një propozim i tillë dhe se "çdo propozim që vjen nga BE-ja dhe ShBA-ja duhet të trajtohet me seriozitet...". Kryeministri Kurti, nëse dikush do të vdiste nga serioziteti i tepruar, me mohimin e këtij propozimi që emisarët e Francës dhe Gjermanisë ia lanë mbi tavolinë, sigurisht se nuk rrezikohet nga vdekja politike. Rezervat për këtë propozim shkonin në favor të atyre që deklaronin se ShBA-ja ende nuk është deklaruar dhe se, pa të, as specat nuk mund t'i shtimë turshi! E ky është preokupimi kryesor i shtetasve të Kosovës në këtë vjeshtë! Pas këtij propozimi oportunist dhe pragmatist jo për ta zgjedhur problemin, por për ta konservuar (shti në turshi) për një afat, së paku 10-vjeçar, për fillim u shtuan vizitat e ndërmyjetësuesve ndërkombëtarë, që nga mashtruesit dhe rrenci, Miroslav Lajçak, i cili më shpesh po takohet me kryeministrin Kurti se me gruan e tij, kolegja e tij, sipas bindjeve politike dhe shpërfytyrim të së vërtetës, Viola

von Kramon, pastaj Gabi Eskobar (me mbiemër të frikshëm që domosdoshmërisht duhet të respektohet) e deri te fosilet politike sikur puna e Ishingerit. Madje nga një harresë plotësisht absolute në skenë u paraqit jo për para, por për ta ndihmuar Kosovën edhe ish-zëdhënësi i NATO-s, Xhimi Shi, thuaja se ka qenë ekspert për zgjidhjen e problemeve globale e, në fakt, ishte një daullexhi i NATO-s, disi si daullexhinjtë e kryeministrit të Kosovës, Përparim Manxhuka dhe Arlind Kryeziu. Në çfarë derexhe ka rënë Kosova që ka mbetur në duar të injorantëve të vendit si puna e Besnik Muçiverces dhe sufleres së ministres për Punë të Jashtme dhe fosileve politike si Baresha Ashton Federika Tortelini, Josip Borrell, Wolfgang Petric dhe mumie të tjera nga piramidat e interesit material. Mbetjet e mumieve f (p)aranoike të diplomacisë evropiane që aktivizohen për vendet e lodhëta e që kanë të theksuar impotencën politike dhe diplomatike! Opozita kosovare, në stilin e një adoleshenteje, po vepron sipas parimit "ku rafsha, mos u vrafsha!", duke mbrehur dhëmbët që, pas dështimit eventual të qeverisë Kurti 2 (jam i sigurt se nuk do të ketë asnjëherë më Kurti 3), të gostitet me mbetjet e kësaj qeverie e që, për mua, është gabim i madh politik dhe strategjik. Se si janë duke shkuar proceset, qeveria Kurti 2 nuk ka gjasa të rrezohet nga ndërkombëtarët, kurse opozita, edhe nëse i siguron numrat, nuk është e gatshme ta rrezojë pushtetin dhe të marrë përgjegjësi për marrëveshjen përfundimtare. Opozita është e bindur se, nëse Kurti e nënshkruan një marrëveshje të pafavorshme (dhe nuk ka gjasa të nënshkruhet një marrëveshje e favorshme me një trashëgimi të marrëveshjeve paraprake), do të ndahet e palagur sikur Krishti kur i ra përmes liqenit. Opozita duhet ta ketë të qartë se asnjë marrëveshje përfundimtare nuk do të nënshkruhet pa e futur opozitën brenda kuadrit, me dëshirë apo me dhunë diplomatike, nuk është aspak me

rëndësi. Pastaj, jam i sigurt se qeveria aktuale nuk do ta refuzojë asnjë marrëveshje, të shkuar apo të re, vetëm se kërkon një ambalazhim përkatës që e ruan përmbajtjen për mashtron me ambalazhim e që duket se është diçka e re, për dallim nga të vjetrat. Do të përpiqet që propozimet e "shkatërruesve të shtetit" t'i zëvendësojë me propozimet e "Shpëtimtarëve të shtetit"! Figurativisht duan që rrotën ta vendosin mbi bajgë në atë mënyrë që të mos e ndajë proporcionalisht por që 99.99 për qind e bajgës së përgjegjësive ta lënë kah opozita dhe vetëm 0.01 për qind kah "shpëtimtarët". Me çdo marrëveshje Serbia do të përfitojë kurse Kosova duhet ta gjejë një mënyrë që sa më lehtë dhe sa më padhimbshëm t'i menaxhojë humbjet. Ashtu është puna. Përrallat e von Kramon se propozimi franko-gjerman është mundësi e mirë për Kosovën dhe se nëse nuk pranohet ky propozim, propozimi i radhës mund të jetë më i keq është shantazh klasik dhe vazhdimësi e politikës së Angela Merkelit, tash kancelarit Sholc që asgjë të mirë nuk i solli Kosovës kurse Serbisë miliarda dhe miliarda euro investime. Ju kujtohet, lexues të nderuar se më parë këshilltari i Merkelit pati propozuar që komunat veriore, përkatësisht asetet ekonomike të menaxhohen në një periudhë 20-vjeçare nga një bord ndërkombëtar (ku do të përfshiheshin një rus dhe një kinez) dhe, pas kësaj periudhe qytetarët do të vendosnin me referendum se me kend duan të jetojnë! Shqiptarëve të Kosovës, me Kushtetutën e kriminelit juridik, Mati Ahtisari i mohohet e drejta për deklarim përmes referendumit! Propozimi i dy gjermanive është shkatërrimtar për Kosovën në planin afatgjatë duke e marginalizuar, deri në mohim dhe shpërbërje këtë strukturë dhe mbindërtim të brishtë shtetëror. Në variantin më të mirë, pasi ta demolojnë Kosovën, mbetjet territoriale do t'i bashkoheshin Shqipërisë. Kosova ka nevojë për zgjidhje radikale dhe të qëndrueshme të problemit me

Serbinë duke u ndarë njëherë e mirë nga ky shtet që asnjëherë nuk do ta lë të qetë Kosovën, sidomos nëse e nënshkruan një marrëveshje të përkohshme dhe të afatizuar. Rrethanat janë kundër Kosovës, lufta në Ukrainë e ka forcuar shumë Serbinë duke e vendosur në pozitë inferiore Kosovën përkundër angazhimit të madhe të kryeministrit dhe presidentes në vendosjen e të gjitha sanksioneve të mundshme Ruisë. Ballkani fuqishëm po kthehet në kthetrat e forcave nacionaliste që e përkrahin Rusinë dhe Putinin; në Bosnje është fuqizuar shumë Dodiku, në Mal të Zi, me përkrahje të pamoralshme të esatpashëtoptanit proserb, Terr Abazović, u rikthyen forcat proserbe, në Maqedoni të Veriut po forcohet shumë partia e Gruevskit dhe në zgjedhjet e ardhshme do të fitojë bindshëm kurse në Serbi, Aleksandar Vučić është bërë më i fuqishëm se Sllobodan Millosheviqi. Ndërkombëtarët, si praktikë dhe pragmatikë që janë, përkundër kundërshtimeve të buta, do të detyrohen të luajnë me këta lojtarë, ndonëse e kanë të qartë përkatësinë dhe orientimin politik të tyre. Kosova do të mbetet si një qengj i metilavtë në mesin e ujvqe pro rusë. Kot e keni ta përkrahni Ukrainën kur nuk jeni në gjendje ta mbronin Kosovën. Presidentja po dekoron gratë ukrainase duke e barazuar këtë dekor me Çmimin Saharov kurse kryeministri Kurti fillimisht sillej me Zielenski se vet Zielenski por se nuk po vishet si ai. Overdoza e përkrahjes në kohën kur askush nuk të pyet për asgjë dhe, madje të përqeshin është e bezdisshme, të shndërron në karikaturë dhe në leshko! Për fat të keq! Modeli i dy gjermanive ka përfunduar me një bashkim të pashmangshëm të një vendi të ndarë dhunshëm e që indikon se modeli i dy gjermanive që po i propozohet Kosovës, në një mënyrë apo tjetër do të krijojë një lidhje varshmërie të Kosovës ndaj Serbisë, nën maskën e një shteti të pavarur dhe sovran. Prandaj, duhet të refuzohet, pa asnjë mëdyshje!

10 muaj vazhdim për tabela, hajgare poshtëruese: Qeveria e Kosovës edhe më herët e ka zhvendosur afatin për konvertim të tabelave me shpresë që pas ftesës publike të kryeministrit Kurti në gjuhën serbe, më duket edhe të Xhelalit, serbët do ta përmbushin këtë detyrim ligjor dhe qytetar, menjëherë! Tash, pasi, sipas palës kosovare janë konvertuar vetëm 15 regjistrime kurse sipas Vuçiqit vetë tre, "miqtë" ndërkombëtarë kanë sugjeruar - urdhëruar që ky afat të zgjatet në 10 muaj. Filloi me Eskobarin, pastaj edhe sekretari Blinken e përsërit e mos të flasim për mashtruesit e Brukselit, Lajçak dhe Borrell, e kush jo tjetër. Edhe opozita kosovare ishte në një linjë me ndërkombëtarët kurse kryeministri Kurti dhe presidentja e kryeministrit, Vojsa Osmani e kundërshtuan këtë duke mos pranuar këtë propozim. Gjërat nuk po më duken aspak të qarta aq më parë që në rast kur sekretari Blinken ka biseduar me kryeministrin Kurti me telefon, i pari që e ka dhënë lajmin ishte pikërisht kryeministri, me një entuziazëm të pamatur. Tash, ta refuzosh këtë, thjesht nuk e kapë koka: ose është një skenar, tekstin e të cilit nuk e kemi, ose, ose, ose... asgjë nuk ka prej kësaj pune. Pavarësisht kësaj, tensionim të situatës mund të ketë vetëm nëse ndërkombëtarët duan këtë për një situatë tjetër politike dhe përkufizim territorial. Mendoj se janë kërkuar 10 muaj duke planifikuar që deri atëherë të formohet Zajebnica të cilës, si shtet në shtet do t'i kaloheshin përgjegjësitë e tabelave, në mes të përgjegjësive tjera shtetërore. Asnjë zgjidhje nuk do të ketë sukses nëse nuk kemi pranimit reciprok kurse Serbia nuk është në gjendje ta bëjë këtë në kohën kur propozimi franko-gjerman në asnjë variant nuk e sugjeron këtë njohje, madje as që e vendosë kusht për arritje të një marrëveshjeje përfundimtare. Pastaj, 10 vjet janë të gjata dhe pas kësaj kohe askush nuk do të merret më me Kosovën! Këtu është rreziku dhe hilja e madhe e propozimit franko-gjerman!

Raqiçi paralajmëron bllokim të rrugëve në veri në rast të konfiskimit të makinave me targa serbe

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 TETOR - Kryetari i Listës Serbe, Goran Raqiçi, ka paralajmëruar bllokimin e rrugëve në veri të Kosovës nëse Kosova ndërmerr ndonjë veprim për konfiskimin e makinave me targa serbe. Por, autoritetet në Prishtinë thanë se Serbia po kërcënon me dhunë vetëm pse Kosova po zbaton ligjin. Këto deklarata Raqiçi i bëri pas takimit të Listës Serbe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Beograd, teksa më 31 tetor pritet të skadojë afati dymujor i vendosur nga Qeveria e Kosovës për konvertimin e targave të lëshuara nga Serbia, në ato RKS - Republika e Kosovës. “Nëse Prishtina fillon me dhunë, me ndonjë veprim lidhur me konfiskimin e automjeteve, ne do t'i bllokojmë të gjitha vendkalimet dhe hyrjet nga veriu drejt Kosovës qendrore”, ka thënë Raqiçi në një konferencë për medie në Beograd. Raqiçi tha se presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i është thënë se nëse “Forcat e Sigurisë së Kosovës, njësitë

speciale të policisë apo dikush tjetër fillon ta konfiskojë pronën tonë dhe pronat tona janë pikërisht targat që janë arsyeja e takimit, ne do t'i përdorim të gjitha mjetet në mënyrë demokratike dhe paqësore, për të rezistuar dhe do të jetë rezistenca e popullit”. “Kur themi rezistencë paqësore demokratike të popullit, ne me të vërtetë atë e duam, por nuk e di se në çfarë do të shndërrohet e gjitha dhe si do të zhvillohet situata në terren. As unë nuk e di dhe askush nga ne që jetojmë atje poshtë se në çfarë do të shndërrohet situata nëse dikush me dhunë fillon të na marrë pronën”, shtoi ai. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se me zbatimin e vendimit për reregjistrimin e makinave, Kosova po zbaton ligjin. Në një konferencë për medie në Prishtinë më 27 tetor, Osmani tha se Prishtina do të punojë me faktorin ndërkombëtar që, siç tha ajo, të parandalohen skenarët destabilizues në rajon. Pas takimit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Vuçiqi ka deklaruar se do të mbeten në përdorim targat KM (Mitrovicë e Kosovës).



Ai, po ashtu, paralajmëroi se populli serb do të bëjë “rezistencë” nëse Kosova pamundëson lëvizjen me targa të lëshuara nga Serbia. “Plani i

tyre [i Kosovës] është që ato vetura të lëshojnë [Kosovën] duke moslejuar që të kthehen në territorin e Kosovës”, ka thënë ai, duke shtuar se “ne jemi të

gatshëm t'i vazhdojmë bisedimet, por ka gjëra që nuk mund t'i pranojmë. Ne i kemi njoftuar për këtë, nuk do të hyj në detaje”.

MBP-ja pranon 80 komente për Projektligjin për Paga

PRISHTINË, 27 TETOR - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, ka bërë me dije të enjten se kanë pranuar komente nga rreth 130 institucione lidhur me Projektligjin për Paga dhe atë për Zyrtarët Publikë. Ai ka thënë se janë duke e bërë të pamundurën që sa më shpejt të përfundojë shqyrtimi i këtyre komenteve dhe pastaj projektligjet t'i dërgojnë për miratim në Qeveri dhe Kuvend. “Kemi pranuar komente nga rreth 50 institucione për Ligjin për Zyrtarë Publikë, kurse për Ligjin për Paga kemi pranuar komente nga rreth 80 institucione dhe më pak

qytetarë pasi nuk preken direkt. Po i trajtojmë me seriozitet që ligji të jetë i mirë. Që nga viti 2012 ky është viti i parë që në raportin e progresit nuk përmendet njolla e zezë e ndërhyrjeve politike në administratë publike”, ka thënë ai. Ndërsa sa i përket koeficientit për paga, Dobra ka theksuar se do të caktohet bazuar në buxhetin e vitit 2023. “Koeficientet janë caktuar duke marrë për bazë disa kriteret, pra është institucioni ku punon, pozita dhe përgjegjësia që keni sikurse edhe kualifikimet”, u shpreh ai në një konferencë për medie.



Drenasi shpall 'Qytetar Nderi' Begajn, Ramën dhe tre ish-presidentët e Shqipërisë

DRENAS, 27 TETOR - Në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit janë aprovuar disa vendime, në mesin e tyre edhe propozimi i kryetarit të kësaj komune, Ramiz Lladrovci, ku me vota unanime janë shpallur

“Qytetar Nderi” presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, kryeministri Edi Rama, ish-presidentët Rexhep Meidani, Alfred Moisiu e Bamir Topi dhe Ana Roch. Lladrovci në “Facebook” ka shkruar se komuna që drejton,

“pjesë e Drenicës dhe Kosovës, e njohur e mirënjohur për mikpritje, liridashës e atdhetarë, djepi i UÇK-së, është e nderuar që të gjithë të shpallurit ‘Qytetar Nderi’, nga sot, me nderim, do t'i ketë në mesin e vet”.



OEK-u paraqet konceptin e Qendrës për Ekonomi Qarkore

PRISHTINË, 27 TETOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka zhvilluar konceptin për themelimin e Qendrës për Ekonomi Qarkore brenda strukturave të saja.

Misioni i Qendrës për Ekonomi Qarkore të Kosovës është të kontribuojë në tranzicionin e sektorit privat drejt ekonomisë qarkore duke nxitur bashkëpunimin përmes komunikimit transparent dhe shkëmbimit të njohurive ndërmjet të gjithë aktorëve

relevante për të siguruar që ekonomia qarkore është përshtatur për aftësitë dhe nevojat e sektorit privat dhe të vendit.

Roli i përgjithshëm i Qendrës/Hub-it është t'i lidhë palët e interesit në mënyrë që të angazhojë, fuqizojë dhe mbështesë sektorin privat në praktikimin e modeleve qarkore të biznesit. Pra, qëllimi ynë kryesor është ta nxisim bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat, akademisë dhe

kërkimit, qeverisë dhe organizatave donatore për të krijuar mekanizma që mbështesin tranzicionin e gjelbërt në Kosovë.

Koncepti i Hub-it për Ekonomi Qarkore është zhvilluar në kuadër të projektit "Përfshirja e ekonomisë qarkore në sektorin privat të Kosovës" që zbatohet nga OEK, mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane.



Mbahet Forumi i Biznesit Greqi - Kosovë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 27 tetor - Në kuadër të vizitës zyrtare në Athinë të delegacionit nga Kosova, të udhëhequr nga ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, është mbajtur Forumi i Biznesit ndërmjet Greqisë dhe Kosovës.

Ngjarja e përbashkët me pjesëmarrje të bizneseve kosovare dhe greke, me organizim nga Agjencia për Promovimin e Investimeve dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Athinës, filloi me fjalimet përshëndetëse të ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari dhe të zëvendësministrit të Punëve të Jashtme për Diplomacinë Ekonomike dhe Hapje të Greqisë, Kostas Fragogiannis dhe vazhdoi me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit nga KIESA, që vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me Enterprise Greece, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë.

Ministrja Hajdari ka theksuar se Forumi i Biznesit paraqet një hap të rëndësishëm për forcimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të Greqisë dhe Kosovës dhe përmendi vizitat e fundit më të shpeshta zyrtare në nivel politik ndërmjet dy vendeve. "Greqia është një partnere e rëndësishme ekonomike për Kosovën dhe sot jemi në



Athinë, një nga qytetet më të vjetra në botë, së bashku me ndërmarrësit tanë me synim forcimin e bashkëpunimit ekonomik në sektorë të industrisë së drurit, tekstilit, ndërtimit, dizajnit grafik, energjisë së ripërtërishme, metalit, produkteve plastike dhe agro-produkteve. Prania jonë sot në Athinë është për ta përcjellë përkushtimin e Qeverisë së Kosovës së bashku me ndërmarrësit tanë, që ky bashkëpunim të jetë i suksesshëm dhe me përfitime

reciproke", ka deklaruar Hajdari. Ministrja Hajdari ka potencuar zotimet dhe angazhimet e Qeverisë së Kosovës, duke qenë gjithmonë e orientuar drejt BE-së me zbatimin e suksesshëm të Agjendës së Reformës Evropiane (ERA) dhe ka siguruar se do të jetë gjithmonë me shikim nga Perëndimi. Ajo solli në pah sektorët industrialë kryesorë dhe në rritje, që janë me potencial plotësues në

zinxhirin rajonal të furnizimit dhe i njoftoi për veprimet e qeverisë, që kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit për të bërit biznes dhe nxitjen e investimeve në Republikën e Kosovës.

Ndërsa zëvendësministri Fragogiannis ka theksuar përkushtimin e Greqisë për thellimin e raporteve me Republikën e Kosovës dhe rëndësinë e bashkëpunimit reciprok në mes dy vendeve për zhvillim ekonomik dhe rajonal. Ai ka potencuar

dyfishimin e shkëmbimeve tregtare mes Greqisë dhe Kosovës në pesë vjetet e fundit dhe ka shprehur gatishmërinë për arritjen e rezultateve konkrete në projekte me interes të përbashkët për të dy vendet.

Forumu u përmyll me takimet e rrjetëzimit të bizneseve kosovare - greke të cilat shkëmbyen përvojat dhe potencialin për krijimin e partneriteteve dhe të rritjes së bashkëpunimit ekonomik Kosovë - Greqi.

Kuvendi miraton projektligjin që përcakton çmimin tavan për produktet bazike

PRISHTINË, 27 TETOR - Me 63 vota për, asnjë kundër e asnjë abstenim, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar të enjten në lexim të parë Projektligjin për masat e përkohshme të

produkteve bazike.

Ky projektligj parasheh që disa produkteve t'u vendoset çmimi tavan.

Gjatë shqyrtimit që është bërë, deputetët e opozitës kanë

shprehur kritika ndaj këtij projektligji duke e kualifikuar antikushitetues dhe në kundërshtim me ekonominë e tregut të lirë.

Ministrja e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka theksuar se ky projektligj është hartuar për shkak të rritjes së paarsyeshme të çmimeve bazë duke shtuar se do të aplikohet në raste të veçanta të




Ja cilat janë sekretet e jetës, sipas shkrimtarit të madh rus, Leon Tolstoi

Ka shumë gjëra për të mësuar në lidhje me Artin e të Jetuarit nga Lufta dhe Paqja e Tolstoit – për kotësinë dhe budallallëkun, xhelozinë seksuale dhe marrëdhëniet familjare. Por ne mund të mësojmë gjithashtu nga jeta e vetë mjeshtrit të romaneve

Roman KRZNAVIC

Tolstoi shte anëtar i fisnikërisë ruse, nga një familje që zotëronte një pronë dhe qindra shërbëtorë. Jeta e hershme e kontit të ri ishte e zhurmshme, imorale dhe e dhunshme. “Unë vrisja njerëz në luftëra dhe i sfidoja njerëzit në duela me qëllim që t’i vrisja”, shkruante ai. “Unë humbisja në bixhoz, konsumoja punën e fshatarëve, i dënoja me



ndëshkime, jetoja i lirë, dhe i mashtroja njerëzit... kështu jetova për dhjetë vjet.” Por ai gradualisht filloi t’i largohej këtij stili jete prej racisti dekadent dhe i hodhi poshtë besimet e marrë prej tabanit aristokratik, duke adoptuar një këndvështrim jotradicional të botës, i cili i trondiste bashkëmoshatarët. Ja çfarë këshillash mund të na ofrojë rrugëtimi personal i Leon Tolstoit, për të riparë filozofinë tonë të jetës.

1. Qëndroni mendjehapur

Një nga dhuntitë më të mëdha të Tolstoit ishte aftësia dhe dëshira e

tij për të ndryshuar mendjen, bazuar në eksperiencën të reja. Gjakderdhja e tmerrshme që ai pa ndërsa luftonte në Luftën e Krimesë në 1850-ën e shndërroi në një pacifist për gjithë jetën. Në 1857-ën, pasi pa një ndëshkim publik në gjiotinë në Paris – ai nuk e harroi kurrë zhurmën e kokës së prerë ndërsa binte në kutinë poshtë – ai u bë një kundërshtar i bindur i shtetit dhe i ligjeve të tij, duke besuar që qeveritë nuk ishin vetëm brutale, por në esencë i shërbenin interesave të të pasurve dhe të fuqishmëve. “Shteti është një komplot,” i shkroi ai një miku. “Prandaj, unë kurrë nuk do t’i shërbej ndonjë qeverie ndokund”. Tolstoi ishte në rrugën e shndërrimit në anarkist. Ai ishte i pari që do të na nxiste të vinim në dyshim besimet themeltarë dhe dogmat me të cilat jemi rritur.

2. Praktikoni ndjeshmërinë

Tolstoi shfaqti një kapacitet të pazakontë për t’u prekur duke e vënë veten në vendin e njerëzve, jeta e të cilëve ishte shumë e ndryshme nga e tija. Në 1860-ën ai jo vetëm adoptoi veshjen fshatare, por filloi të punonte krahpërkras me punëtorët e sapoemancipuar në pronën e tij, duke punuar me parmëndë fushat dhe duke riparuar shtëpitë e tyre me duart e tij. Sigurisht që kishte një element paternalizmi, por e vërteta është se ai e shijonte shoqërinë e fshatarëve dhe në mënyrë të vetëdijshme i largohej elitës letrare dhe aristokratike në qytete. Tolstoi besonte se ju nuk mundet kurrë të kuptoni realitetin e jetës së njerëzve të tjerë, nëse nuk e provoni vetë atë.



3. Bëni ndryshimin

Ai u dallua nga moshatarët e tij të kastës së lartë duke ndërmarrë veprime praktike për të lehtësuar vuajtjen e njerëzve të tjerë, më evidente ishte puna e tij për lehtësimin e urisë. Pas dështimit të të lashtave në 1873-shin, Tolstoi ndaloi së shkruari Ana Kareninë-n për një vit, me qëllim që të organizonte ndihmë për ata që vdisnin urie. Në këtë kohë, ai i shkruante një të afërm: “Nuk mund të shkëputem nga krijesa që janë reale, për t’iu kushtuar krijesave imagjinare”. Shokët e tij, ashtu si edhe familja, menduan se ishte çmenduri që njëri nga romancierët më të mirë t’i vendoste veprat e tij gjeniale në plan të dytë. Ai e përsëriti këtë gjë gjatë zisë së bukës së 1891-shit, kohë kur kaloi dy vite duke punuar në “kazanët e supës” dhe për mbledhje fondesh. A mund ta imagjinoni dot një shkrimtar të sotëm, nga ata që shesin shumë kopje, që të lënë mënjane librin dhe t’i kushtohen për dy vite punës humanitare?

4. Zotëroni artin e të jetuarit thjeshtë

Pas një krize nervore në fundin e vitit 1870, Tolstoi hodhi poshtë gjithë fenë e organizuar, duke përfshirë Kishën Ortodokse në të cilën ai ishte rritur. Ai adoptoi një lloj revolucionar të Kristianizmit i bazuar në jetën e thjeshtë shpirtërore e materiale. Ai i dha fund alkoolit, duhanit dhe u bë një vegjetarian. Tolstoi frymëzoi

gjithashtu krijimin e komuniteteve utopike të jetesës së thjeshtë, ku pasuria ishte e përbashkët. Këto komunitete “Tolstojane” u përhapën rreth e rrotull botës dhe e shtynë Gandin të themelonte një vendbanim fetar në 1910-ën, me emrin Ferma “Leo Tolstoi”.

5. Kujdes nga kontradiktat tuaja

Kjo jetë e re, më e thjeshtë nuk ishte pa mundime dhe kontradikta. Tolstoi predikonte dashuri universale, megjithatë ishte në mënyrë konstante në luftë me të shoqen. Veç kësaj, apostulli i barazisë nuk ishte kurrë i aftë të braktiste plotësisht pasurinë dhe jetën e privilegjuar. Ai jetoi deri në moshë të madhe në një shtëpi të madhe me shërbëtorë. Por në fillim të 1890-ës ia doli – kundër dëshirës së familjes së tij – të hiqte dorë nga drejta e autorësisë për një pjesë të madhe të veprave të tij letrare, si pasojë duke sakrifikuar një pasuri të tërë. Duke marrë me mend pozicionin e privilegjuar në të cilin Tolstoi e filloi jetën, transformimi i tij shpirtëror, gjithësesi është për t’u admiruar.

6. Bëhuni zanatçi

Tolstoi kuptoi që arritja e një ekuilibri midis mendjes dhe trupit ishte një pjesë thelbësore e procesit të tij krijues. Ai jo vetëm e linte vazhdimisht penën për të marrë plugun mospërmas fushës, por mbante një kosë dhe priste me

sharrë duke u mbështetur pas murit ngjitur me tavolinën e shkrimit. Në vitet e tij të fundit, kur gazetarë e shkrimtarë vinin të respektonin plakun e zgjuar me mjekër, ata gjithmonë befasoheshin kur gjenin një nga autorët më të famshëm botërorë të mbledhur kruspull mbi veglat e punës, duke bërë një palë çizme. Nëse Tolstoi do të ishte këtu sot, ai pa dyshim do të na sugjeronte të fusnim ndonjë zanat në jetën. Më mirë se sa të kalonim kaç shumë kohë në twitter apo duke bërë mesazhe.

7. Zgjeroni rrethin tuaj shoqëror

Leksioni më themelor për jetën që ofron Tolstoi është të kuptojmë se rruga më e mirë për të sfiduar hamendësimet dhe paragjykimet tona, dhe të gjejmë rrugë të reja mbi vështrimin e botës është ta rrethojmë veten me njerëz, pikëpamjet e të cilëve dhe stili i jetës së të cilëve ndryshon nga i yni. Tek “Ringjallja” ai tregoi se shumica e njerëzve – qofshin ata politikanë, biznesmenë ose hajdutë – “instiktivisht kapen pas rrethit të atyre njerëzve që ndajnë pikëpamjet e tyre për jetën dhe vendin e tyre në të”. Të përkëdhelur brenda grupit të shoqërisë sonë, ne mund ta mendojmë absolutisht normale dhe të justifikueshme të zotërojmë dy shtëpi, ose të kundërshtojmë martesat brenda të njëjtit seks, ose të bombardojmë vendet në Lindjen e Mesme. Ne nuk e shohim që pikëpamje të tilla mund të jenë perverse, të padrejta, ose të pavërteta, sepse ne ndodhemi brenda qarqeve që vetë i kemi krijuar. Sfidat është t’i përhapim krahet e bisedës tonë dhe të harxhojmë kohë me ata njerëz, vlerat dhe eksperiencat e të cilëve bien ndesh me tonat. Tolstoi do të na këshillonte se detyra jonë finale është të udhëtojmë përtej perimetrit të rrethit. / *bookoflife* – *www.bota.al*

Rasti i çuditshëm i Benjamin Button dhe apeli i tij ndaj njerëzve

I frymëzuar nga romani i Francis Scott Fitzgerald i vitit 1922, filmi me regji të David Fincher u nominua për 13 çmime Oscar në vitin 2009. Një orë me akrepa që lëvizin në drejtimin e kundërt, lidhet me magjinë e një fëmije që lind i moshuar, dhe që ditë pas dite bëhet më i ri.

Në fakt, protagonistin i vërtetë i filmit është koha, e zbritur nga natyra konvencionale që i ka atribuar njeriu. Është një kohë që ecën me shpejtësi, dhe që na nxit të reflektojmë mbi kuptimin e një ekzistence, e cila nuk karakterizohet më nga perspektiva e plakjes, por nga ndjenja, nga aftësia jonë për të pajtuar fëmijën dhe të rriturin që jetojnë brenda secilit prej nesh.



Monologu mbi jetën

Një kohë që mund të ri-shpiket, dhe pas së cilës nuk mund të fshihemi, sepse siç e thotë edhe vetë Benjamin Button në monologun e famshëm mbi jetën “nuk është kurrë vonë, ose në rastin tim shumë shpejt, të jesh ai që dëshiron të jesh”.

“Për atë që ia vlen, nuk është asnjëherë vonë, ose në rastin tim shumë herët, të jesh ai që dëshiron të jesh. Nuk ka një kufi kohor, kur mund të filloni kur të doni, kur mund të ndryshoni apo

të qëndroni ashtu siç jeni. Për këtë nuk ka një rregull. Ne mund të përjetojmë gjithçka, për mirë e keq qoftë.

Unë shpresoj që ju ta përjetoni gjithçka në maksimum. Shpresoj që ju të keni mundësi të shihni gjëra të mahnitshme, shpresoj që të keni gjithmonë emocione të reja. Shpresoj që të mund të takoni njerëz me këndvështrime të ndryshme. Po ashtu, shpresoj të jeni krenarë për jetën tuaj, dhe nëse zbuloni se nuk jeni, atëherë shpresoj që të gjeni forcën për t’ia nisur nga e para”.

Rasti kurioz i Benjamin Button

Për Benjamin Button jeta ecën në

drejtimin e kundërt. Në një ditë vere të vitit 1860, pas një kthesë të pashpjegueshme të fatit, ai lindi i moshuar: një burrë me pamjen e një 70-vjeçari në një djep. Dhe pastaj fillon të rinohet, duke lëvizur kundër rrymës së historisë.

Borgjezia e Baltimorës, së cilës i përket edhe babai i tij, e sheh me një përzierje ndjenjash midis habisë, sikletit dhe kundërshtimit. Një roman shumë i rafinuar, bazuar në atë që F. Scott Fitzgerald e konsideroi si rrëfimin e tij më zbatimës. E njëjta frymë përshkon edhe flimin e realizuar nga David Fincher me protagonistë aktorët e mirënjohur Brad Pitt dhe Cate Blanchett. / *Libreriamo* – *Bota.al*

Historia e fotografisë së “ngacmimit”



Nga: Daut DAUTI

Kjo fotografi historike quhet “An American Girl in Italy” (Një vajzë amerikane në Itali) dhe është bërë në vitin 1951 në Firence. Vajza amerikane, 23 vjeçe, e quajtur Ninalee “Jinx” Craig, shihet duke e kaluar një “kordon” të 15 burrave që e ngacmojnë me fjalë dhe gjeste. Kjo ka qenë koha kur nuk ka ekzistuar shprehja “ngacmim seksual”. Fotografia është përdorur më vonë dhe përdoret

edhe sot nga feministet për ta ilustruar poentën e ngacmimit seksual.

Craig deri në vdekjen e saj më 2018, kurrë nuk ka pranuar se është ngacmuar seksualisht në këtë foto, dhe ka bërë kërkesa që kjo të mos përdoret për atë qëllim. Përgjigjja e saj zakonisht ka qenë: “Nuk e kam ndier veten aspak në rrezik ... jam kënaqur ... çka pret tjetër femra kur kalon nëpër det meshkujsh?”

Në fakt, vajza duket e brengosur nga shikimet dhe me siguri edhe nga fjalët e këtyre burrave. Por, fotografia është përgatitur të

jetë e tillë. Ajo që në të vërtetë ka ndodhur është se vajza ka kaluar mes këtyre burrave dhe aty ka qëlluar fotografia Ruth Orkin që ka parë këtë skenë, por që nuk kishte kohë të nxirrte aparatit. Prandaj, e ka lutur vajzën që ta përsëris kalimin edhe një herë, kurse burrat i ka porositur që ta bëjnë të njëjtin veprim, por të mos shikojnë në drejtim të aparatit fotografik. Pra, në një mënyrë ky është aktrim. Vajza ka menduar se duhet të duket e brengosur, kurse burrat kanë menduar se duhet të jenë më aktivë me

ngacmimin.

Ruth dhe Ninalee janë njoftuar një ditë më herët në Itali dhe janë bërë shoqe. Ato kanë udhëtuar nëpër Evropë, pa shoqërinë e askujt – kohë kjo kur ka qenë e pazakonshme për gratë që të udhëtojnë pa burra. Sidoqoftë, në një revistë amerikane turistike, kjo fotografi është botuar në vitin 1953 me titull “Don’t Be Afraid to Travel Alone” (Mos ke frikë të udhëtosh vetëm). Por, fotografia ka qenë e retushuar pasi ai tipi që duket në krahun e djathtë të vajzës dhe që me dorë e mban të

shtrënguar “sendin” mes këmbëve, ka qenë i hequr. Atëherë është menduar se është e tepërt kjo pamje, për t’u botuar.

Por, edhe sikur të ishte botuar pa redaktim, nuk do të flitej për ngacmim seksual për shkak se kjo temë atëherë nuk ka ekzistuar sikur sot. Pos kësaj, vajza në fotografi gjithmonë e ka refuzuar emërimin e tillë të aktit që shihet në këtë foto. Nëse vajza e ka mohuar ekzistimin e ngacmimit seksual, a duhet të tjerët të insistojnë: “Po, këtu ka ngacmim seksual?”

Elbenita Kajtazi në ballinën e revistës prestigjioze operistike

Sopranoja e njohur kosovare Elbenita Kajtazi e cila po shënon suksese të panumërta, së fundi ka zënë edhe ballinën e një prej revistave më prestigjioze operistike.

Për muajin nëntor, sopranoja Elbenita Kajtazi është zgjedhë të jetë në ballinën e revistës Das Opernglas.

Sopranoja Elbenita Kajtazi ka njoftuar për këtë intervistë të dhënë për këtë revistë, intervistë që ka zënë edhe ballinën e kësaj reviste.

“Nder i madh të jem në kopertinën e revistës së mirënjohur Das Opernglas, intervistë të cilën do e mbaj mend gjatë!”, ka shkruar Kajtazi.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Dështim historik i futbollit spanjoll në Ligën e Kampionëve

MADRID, 27 TETOR - Edicioni aktual i Ligës së Kampionëve ishte një dështim i vërtetë për ekipet spanjolle. Tri nga katër skuadrat pjesëmarrëse janë eliminuar qysh në fazën e

grupeve. Barcelona, Sevilla dhe Atletico Madridi i kanë dhënë fund herët garës më prestigjioze evropiane. I vetmi që është kualifikuar në të tetën e finales është Real Madridi. Që kur ka

nisur reformimi me katër skuadra pjesëmarrëse të një shteti në Ligën e Kampionëve, respektivisht nga sezoni 1999/2000, nuk kishte ndodhur kurrë që Spanja ta ketë vetëm një

skuadër në mesin e 16 më të mirave në fazën eliminuese. Padyshim ky ishte një sezon për t'u harruar për ekipet spanjolle, të cilat do të jenë më të përfaqësuara në Ligën e Evropës.



FBK-ja ndalon udhëtimin e tifozëve mysafirë

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se ka ndaluar udhëtimin e tifozëve mysafirë në mënyrë të organizuar në ndeshjet e "Prince Caffè Superligës" së Kosovës deri në fund të edicionit 2022/23. "Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) konform nenit 23 të statutit të FBK-së ka marrë vendim që ta ndalojë udhëtimin e tifozëve mysafirë në mënyrë të organizuar në ndeshjet e 'Prince Caffè Superligës' së Kosovës deri në fund të edicionit 2022/23 dhe ky vendim do të vlejë vetëm për ndeshjet e organizuara nga

klubet, e jo në ndeshjet dhe eventet e organizuara nga Federata e Basketbollit e Kosovës (si Superkupa, Final 8 etj.). Bordi i FBK-së ka qenë i detyruar të marrë një vendim të tillë, duke u bazuar në disa nga ngjarjet e fundit që kanë ndodhur me tifozët në ndeshjet e basketbollit dhe për të evituar probleme edhe më të mëdha në të ardhmen, atëherë Bordi ka vendosur të ndërmarë masa në këtë drejtim", është thënë në vendimin e kësaj federate. FBK-ja ka bërë me dije se vendimi në fjalë hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.



Boksieres Sadiku i ndahen tetë mijë euro

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Pas suksesit në Kampionatin Evropian të Boksit, ku ka marrë medaljen e bronzë, boksiera Donjeta Sadiku është pritur në takim nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Me këtë rast, Sadikut i janë ndarë tetë mijë euro për suksesin e arritur. "Donjeta Sadiku, pas medaljes botërore, tash me të bronzën evropiane dhe me plot vendosmëri edhe drejt medaljes olimpike. Gjithmonë janë shumë frymëzuese dhe të japin motiv shtesë takimet me sportistet tona që me angazhimin e tyre po na bëjnë krenarë të gjithëve. Boksieren Donjeta Sadiku, bashkë me trajneren

Marjola Sallauka, kryetarin e Federatës së Boksit, Enver Krasniqi dhe sekretarin e përgjithshëm, Latif Demolli, i prita në kabinet. I urova për medaljen e re që i sollën shtetit tonë, të bronztën në Kampionatin Evropian, ndërsa i ndamë shpërblimin në vlerë prej tetë mijë eurosh për Donjetën dhe katër mijë euro për trajneren Marjola Sallauka, bazuar në rregulloren për shpërblime të sportistëve, të cilët arrijnë rezultate kulminante në gara ndërkombëtare. Donjetës i uroj suksese të radhës!", ka shkruar Çeku në "Facebook". Kampionati Evropian i boksit është mbajtur në Budva të Malit të Zi.

Lotito: Igli Tare do të mbetet gjatë në Lazio

ROMË, 27 TETOR - Igli Tare është në rolin e drejtorit sportiv të Lazios që nga viti 2008. Ish-sulmuesi shqiptar me plot sukses ka ushtruar këtë profesion te skuadra nga kryeqyteti italian dhe vitet e fundit ka pasur shumë zëra për të ardhmen e tij. Megjithatë,

presidenti i Lazios, Claudio Lotito, ka konfirmuar se Tare nuk ka qenë asnjëherë në diskutim. Gjithashtu, i pari i klubit kryeqytetas ka thënë se Tare do të mbetet edhe gjatë në Olimpico në rolin e drejtorit sportiv të Lazios. "Roli i Tares si

drejtor sportiv nuk është vendosur në asnjë moment në dyshim. Këtu flas edhe për të ardhmen. Tare nuk është në dyshim", është shprehur Lotito. Tare ka kontratë me klubin kryeqytetas deri në verën e vitit 2023, por së shpejti pritet të nisin kontaktet për vazhdimin e

bashkëpunimit mes palëve. Këtë sezon Lazio është duke zhvilluar një sezon mjaft pozitiv dhe në Serinë A mban vendin e tretë në ligën elitare italiane me 24 pikë të grumbulluara, duke regjistruar shtatë fitore, tri barazime dhe vetëm një humbje.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1538/1
Dt. 27.10.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ (MPMS) 07/2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) 07/2017, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur si dhe në bazë të kërkesës së shkollës shpall:

Ri- SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj në paralelën e ndarë në Mitrovicë për pozitën instruktor/e për nivelin 5 të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"

Në kontekstin e reformave të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka zhvilluar nivelin e 5(pestë) të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".

Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj është e akredituar nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON për të ofruar kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".

Për këtë gjeneratë kualifikim "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" do të ofrohet në Qendrën e Kompetencës (QeK) - Ferizaj - dhe në paralelet e ndara: Qendrën Burimore "Përparimi" - Prishtinë, Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeqovi" - Prishtinë, Qendrën Burimore "Lef Nosi" - Prizren, dhe Qendrën Burimore "Nëna Terezë - Mitrovicë. Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj menaxhohet nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur.

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës Ferizaj	Mitrovicë	1 (një) Instruktor/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"	Vend i lirë për një (1) vit shkollor

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktorin e nivelit të V-të arsimin

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.
- Implementon programin e këtij kualifikimi duke respektuar plotësisht standardet BTEC;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

Kualifikimi dhe dokumentacioni i kërkuar për pozitën Instruktor/e:

- Diploma e nivelit 6 (bachelor) ose më lartë (ose instruktor profesional me kualifikim postsekondar) sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet:

Bachelor ose nivel postsekondar për Arsim gjithëpërfshirës, Bachelor ose nivel post sekondar për Edukim të fëmijëve me nevoja të veçanta ose kualifikim i përafërt;

- 5 vite përvojë pune në profesion, ndërmarrje, biznes dhe në institucione tjera
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës;
- Të këtë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë certifikuar nga PEARSON ose kandidatët e diplomuar në këtë kualifikim;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt.

Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen;
- Shkathtësi themelore kompjuterike dhe kapacitete për t'ia përshtatur në mënyrë sa më të lehtë përdorimin e veglave të TI dhe sistemet e informimit.

Procedurat e konkurrimit

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacioni dhe dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen (në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërtesa MASHTI-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p. n, Prishtinë. Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, CV-ja, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abirapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Naser Berisha shpall të pavlefshëm Diplomën e Bachelorit dhe Masterit të Kolegjit "Biznesi"- Prishtinë, Programi: Menaxhimi i Emergjencave.

Naser Berisha shpall të pavlefshme certifikatën me numër Nr:052, e lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

"Ternava Transport" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810105850.

"Gurmania Production" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811432369.

Fixhrije Xhigolli shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M të lëshuar me 21 qershor 1985.

Shyhrete Morina shpall të pavlefshme diplomën e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në vitin 2018 nga Kolegji AAB.

Avdi Mjeku shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të Xehetarisë 1988\89.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.